

LEXMARK  
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR  
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I  
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHITËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP  
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION  
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË  
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488  
ALDO: 07494181220  
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,  
27-37 Station Road, Hayes, UB3  
4DX



*The Albanian*

VITI I 20 I BOTIMIT 10 SHKURT 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

## A DO TË VOTOJË DIASPORA NË ZGJEDHJET E ARDHSHME?



PETRIT KUÇANA

**A KA FRIKË QEVERIA  
SHQIPTARE  
NGA VOTA  
E DIASPORËS?**



ARBEN MANAJ

**PËRPLASJE PËR  
AZILKËRKUESIT SHQIPTARË  
HOME OFFICE KISHTË  
APLIKUAR PROCEDURË  
SEKRETE PËR VIKTIMAT  
E TRAFIKIMIT**

**KRYEMINISTRI  
NJËZETPËRQINDËSH**

DAUT DAUTI



**EDHE JUGOSLLAVIA PATI  
PRESIDENT SHQIPTAR, POR  
SHQIPTARËT NUK E DONIN!**

KIM MEHMETI



**HESHTJA E RAMËS PËR  
AKUZAT E AHMETAJT, ZGJATJE E  
AGONISË DHE E NDARJES MË  
TË PADENJË NGA PUSHTETI**

IRENA BEQIRAJ



**PIKA TË ZEZA, APO TË  
NDRITSHME?**

DITMIR BUSHATI



**NJË KAPELË  
EVROPIANE  
PËR "KRIZËN E DINARIT"**

VETON SURROI



# Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545




The Albanian newspaper in London


**THE ALBANIAN**  
[www.thealbanian.co.uk](http://www.thealbanian.co.uk)
[www.thealbanian.co.uk](http://www.thealbanian.co.uk)

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Mbase do të ngjante tejet cinike kjo pyetje, por vazhdon të mbetet kokëfortë për realitetin e pandryshueshëm shqiptar. Cinik, në kufijtë e të patolerushmes, mbetet qëndrimi i kryeministrit që këto ditë vazhdon të heshtë për votën e diasporës. Kthehet në faj çdo lloj qëndrimi, heshtje apo përbuzje për votën e diasporës ndërkohë që është detyrim kushtetues, pra Gjykata

## A DO TË VOTOJË DIASPORA NË ZGJEDHJET E ARDHSHE?

Kushtetuese e ka përcaktuar si taksativë votën e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë. Duket se për pushtetin vendimet e Gjykatës Kushtetuese qenëkan edhe fakultative ( Vota e diasporës, mandati i Xhaçkës)... E paingjueshme për një shtet ligjor. Ajo çka mbetet e patolerueshme është heshtja e insitucioneve të diasporës, atyre që kanë mbetur pas shkrirjes së institucionit të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, një prej tyre është KKD- Këshilli Kombëtar i Diasporës.

As gëk as mëk nuk kemi dëgjuar prej tyre, ndonëse lehtësisht mund të konsiderohen që u përdorën edhe në të ashtuquajturin Samitin e fundit të Diasporës. Besohet që Këshilli Kombëtar i Diasporës, një

grup shqiptarësh të përzgjedhur nga qeveria shqiptare, pra jo përfaqësues, të pazgjedhur nga shqiptarët, por të përzgjedhur nga qeveria, presupozohet se do të ishin mbrojtës të flaktë të intereseve të shqiptarëve në Diasporë. Mjerisht nuk kemi dëgjuar qoftë edhe një deklaratë të tyre në lidhje me çështjen më të ndjeshme siç është vota e diasporës apo për çështje të tjera në shtetet përkatëse siç ishte edhe rasi i Britanisë, ku shteti shqiptar nuk ju gjend afër familjarëve të shqiptarëve që humbën jetën këtu dhe askush nuk foli. Kurrsesi KKD nuk mund të konsiderohen si garniturë për mezen e përgatitur në kuzhinat qeveritare dhe as dekor në fotografinë me kryeministrin apo yje në dekorin kryeministrot.



A do të ketë kuptim më KKD-ja apo institucione të tjera të diasporës nëse edhe këtë here nuk do të realizohet e drejta legjitime e shtetasve shqiptarë me banim jashtë territorit të Shqipërisë? Kurrsesi jo. Këto janë momentet, kjo është koha që ata duhet të flasin, pasi nuk ka ndonjë organizëm tjetër që mund të mbrojë interesat e shqiptarëve në diasporë. Në fillim të viteve 1900 në Amerikë kishte rreth 5000 shqiptarë, sipas Ilir Ikonomit në librin "Apostuli". Po sot pas më shumë se

e diasporës?

Tani është koha për të provuar të kundërtën. Mbetet tejet e qartë se jo vetëm qeveria, por të gjithë janë të bindur se vota e diasporës nuk mund të blihet (me paratë e incineratorëve ose jo), nuk mund të shantazohet (asnjë votues i diasporës me vendet e punës) ashtu siç nuk ka patronazhistë që mund të plotësojë misionin e tij prej patronazhisti në emër të partisë me shqiptarët e diasporës.

një shekulli sa janë në Amerikë? Po në Evropë? Po nëpër botë?... Qeveria shqiptare nuk e ka parë të arsyeshme që të regjistrojë shqiptarët në diasporë, (ka më pak kokëdhimbje prej tyre). A ka frikë qeveria shqiptare nga vota

# AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK


**Haris Ali Solicitors**

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

# IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA  
NDRYSHIMET E SHUMTA  
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE  
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE  
QARTESI?!

-NUK JENI  
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232  
Strand, Temple, London,  
WC2R 1DA

## NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi  
Aplikime/ri-aplikime nga e para  
Apelime ne te gjitha gjykatat  
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



**Keni nje Bizness qe po rritet?**

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE  
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

**BUSSINESS IMMIGRATION**  
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER  
**SPONSORSHIP LICENSE**

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi  
Restorante/café  
Car washes

Care homes  
Office work  
Berber

**\*DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:  
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk  
enquiries@imperiumchambers.co.uk  
Website:  
www.imperiumchambers.co.uk  
YouTube:  
The Immigration Barrister



### ARBEN MANAJ

The Guardian e Londrës, jep lajmin se ish-Kryeministrja Teresa May, por edhe politikane të tjerë të rëndësishëm britanik, do konfrontohet me Home Office, Ministrinë e Brendshme britanike dhe atë të Emigracionit, pasi është zbuluar se ky departament ka aplikuar një politike sekrete azili që ajo e quan “të tmerrshme, nga e cila janë prekur 1500 persona, që janë vërtetuar se kane qene viktime te trafikimit dhe skllavërisë moderne.

Në një vendim të jashtëzakon-

shëm të Gjykatës së Larë britanike të disa ditëve më parë, thuhej dhe konkudohej se Home Office kishte operuar politikën sekrete që afektonte të drejtat e këtyre viktimave, të cilat edhe pse gjykatat kishin vendosur që në vitin 2021, se viktimat tashme te konfirmuara si te tilla do u duhej dhenë e leja e qëndrimit në Britani, në kohën që kërkesat e tyre për azil shqyrtoheshin nga autoritetet e emigracionit.

Por Home Office britanik i kishte mbajtur këto raste për muaj të tërë pa proceduar, duke ndaluar individët e prekur nga e drejta e punës, strehimit, hapja e llogarive bankare apo marrja ndihmave so-

# PËRPLASJE PËR AZILKËRKUESIT SHQIPTARË HOME OFFICE KISHTE APLIKUAR PROCEDURË SEKRETE PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT



cialë që jepën ne te tilla raste për azilkërkuesit.

Rasti doli në pah në emër të një shtetasi shqiptar i cili kishte mbërritur në Britani, pasi ishte rrëmbyer në Shqipëri dhe ishte detyruar me force të shpërndante dhe shiste lëndë narkotike.

Një zëdhënës i Home Office tha se ne do të mbajmë shënim vendimin e Gjykatës se Larte dhe do marrim ne shqyrtim implikimet e këtij vendimi te fundit dhënë nga Gjykata e Lartë britanike.

HA  
HARIS ALI SOLICITORS

## KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: [contact@harisalisolicitors.co.uk](mailto:contact@harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

# LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E  
EMIGRACIONIT

## A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



## PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuara
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


## CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

## SHËRBIME TË REJA:

### 1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:

Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.

### 2. Ndihmë e dhembshur për të drejtën e familjes:

Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.

### 3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:

Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

ARBEN MANAJ

Britania i ka dhënë muajt e fundit katër ruandezëve të drejtën e azilit në kohën që qeveria e saj argumenton se ky shtet i Afrikës ekuatoriale, është sipas Kryeministrit Rishi Sunak, qartësisht një vend i sigurt.

Ka qenë një hetim i gazetës britanike "The Observer", që zbulon për herë të parë, vendimet e dhëna nga Ministria e Brendshme dhe e Emigracionit, Home Office, për t'u dhënë statusin e refugjatit katër shtetasve të Ruandës, gjatë katër muajve të fundit, të cilët pretendonin se ishin të rrezikuar nga regjimi në Ruanda. Madje mësohet se një nga vendimet e dhëna është bërë në 12 tetor të vitit të kaluar, pikërisht një ditë pasi qeveria mbylli argumentimin e saj përpara Gjykatës së Lartë britanike, ku theksonte se Ruanda ishte vend tërësisht i sigurt.

Sipas The Guardian, Hetimi i referohet edhe një dosieri të një agjencie perëndimore të inteligjencës, ku Ruanda akuzohej se orkestronte një fushatë denigruese dhe frikësuese, ndaj kritikëve të saj, të vendosur në Britani.

Londra, pasi Shqipëria refuzojë të pranojë planin e kryeministrit Sunak, që emigrantët e mbërritur në Britani me gomone të vendoseshin në Shqipëri, për t'ju shqyrtuar kërkesat e tyre, përzgjodhi Ruandën si vend të sigurt për t'i dërguar, një vend 9 orë larg me avion nga Londra, plane që deri më tani janë hedhur poshtë nga gjykatat më të larta britanike.

Ndërkohë edhe Shqipëria konsiderohet vend i sigurt nga qeveria britanike dhe andaj ka nënshkruar marrëveshjen e riatdhesisimit të azilkërkuësve shqiptarë, që vijnë në Britani, mes dy kryeministrave respektivë, Rama dhe Sunak, sakaq në gjykatat britanike, Top-Channel në Londër, mëson se vetëm nga një studio avokatore kanë fituar azilin me dhjetëra shqiptarë, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, që bazohej në faktin se Shqipëria është vend i sigurt, për Britani.


# BRITANIA, AZIL RUANDEZËVE! VENDI AFRIKAN KONSIDEROHET TEJET I SIGURT NGA QEVERIA E SUNAK



La Rotonda offers a combination of hearty Italian food, a vast selection of fine wines and an exceptional service all in a relaxed atmosphere



## La Rotonda



229 Muswell Hill Broadway,  
Muswell Hill, London N10 1DE



BOOK NOW FOR AN UNFORGETTABLE TIME 020 8374 3949

24 hours a day  
7 days a week



**Call now**  
**07471 875 251**


[www.24-7emergencyplumbing.co.uk](http://www.24-7emergencyplumbing.co.uk)  
[info@24-7emergencyplumbing.co.uk](mailto:info@24-7emergencyplumbing.co.uk)



**EMERGENCY PLUMBER  
& DRAINAGE SERVICES**

**Oferta speciale për kompanitë  
shqiptare në Londër**

- Drain Unblocking
- Drain Jetting
- Drain Cleaning and Descaling
- Drain Repairs
- Drain CCTV
- Sink unblocking
- Toilet unblocking



**24/7**

**PLUMBING  
& DRAINAGE**





**DAUT DAUTI**

Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut si popull shtetformues i nje vetem maqedonët kurse shqiptarët janë minoriteti i barabartë me turqit, romët dhe vllahët. Ja çka thuhet në Preambulën e kësaj kushtetute:  
 “Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës [...] si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas”.  
 Sqarim:  
 Pra, për formimin e këtij shteti kanë

luftuar vetëm maqedonët. Problemi i dytë këtu është ajo që thuhet se ky shtet është ndërtuar në parimet e Republikës së Krushevës. Duhet të theksohet se Republika e Krushevës është formuar në gusht të vitit 1903. Në Krushevë ka qenë e themeluar Asambleja e Përkohshme me 60 anëtarë: 20 shqiptarë, 20 maqedonë dhe 20 vllahë. Kjo Asamble e ka themeluar qeverinë gjashtëanëtarëshe, e cila ka qenë e përbërë nga 2 shqiptarë (Nikolla Balo dhe Gjorgji Çaçi), dy maqedonë dhe dy vllahë. Pasi që republika e sotme e Maqedonisë Veriore proklamoi se është themeluar në bazat e Krushevës, atëherë pse nuk i ka barazuar shqiptarët me maqedonët? Duhet theksuar se kryengritja e Ilindenit dhe Republika e Krushevës nuk do të ndodhnin kurrësi pa shqiptarët. Kjo kushtetutë e ka përmbysur tërë idenë e Republikës së Krushevës. Pastaj, duhet hedhur një sy edhe Amandamentit V të kushtetutës së sotme të Maqedonisë, që thotë: “Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e

# KRYEMINISTRI NJËZETPËRQINDËSH



saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. [...] Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së

paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve, në të cilat flasin së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njëjësive të vetadministrimit lokal”.  
 Sqarim:  
 Në mënyrë të qartë shihet sanksion-

imi i superioritetit të maqedonëve ndaj shqiptarëve që bëhet përmes gjuhës. Shifra 20% është zëvendësim për gjuhën shqipe. Pra, në mënyrë që të mos përmendet termi ‘gjuha shqipe’, kushtetuta e obligon politikën, ligdhënësit, administratën dhe qytetarët që të përdoret shifra 20%. Kjo ndodhë përkundër faktit që regjistrimi i fudit i popullsisë tregon se banorë rezidentë dhe jorezidentë në këtë vend janë 29.5% shqiptarë kurse maqedonë 54.2%. Nëse ‘faktori’ politik shqiptar i din këto gjëra, atëherë si ka lejuar të largohet nga parimet e Republikës së Krushevës dhe pse ka lejuar të shndërrohet nga shqiptar në 20%? Në këto kushte të euforisë naive shqiptaro-balkanike mund të festojnë vetëm krunët e partisë politike shqiptare në pushtet. Emërimi i një shqiptari në pozitën e qeverisë teknike të Maqedonisë nuk ka ndonjë domethënie të rëndësishme. Përkundrazi, maqedonët me këtë akt i kanë shpërblyer shqiptarët me këtë pozitë si shenjë falënderimi që kanë qëndruar urtë, të gjunjëzuar dhe nuk i kanë kërkuar të drejtat e tyre.

**Apollonia Transport**

**TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI**

**SHQIPËRI**

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat  
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

**BRITANI**

Londër - Birmingham  
Manchester - Leeds - Luton

**NA KONTAKTONI**

**UK: 00447429200952**

**AL: 00355682948843**

**AL: 00355694031009**

**TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI**

**+44 7741 588799**

**+355 67 728 2828**

**SHQIPËRI**

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

**ANGLI**

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

**Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë**

Ju Faleminderit qe na besoni!

# Dotech

## websites

**Akoma nuk keni një website?**

Akoma nuk jeni regjistruar në Google



**NA KONTAKTONI**



**020 7018 7929**  
**073 4066 5946**  
**078 5997 7545**

**Adresa e Zyrove**  
**30 Avenons Road**  
**London E13 8HT**

## ARBEN MANAJ

Mbreti i Mbretërisë së Bashkuar, Charles III, është diagnostikuar me një formë të kancerit dhe ka nisur trajtimin, njoftoi Pallati Bakingam më 5 shkurt.

Më pak se 18 muaj në mbretërimin e tij, Mbreti Charles do të pezullojë detyrat publike, por do të vazhdojë të merret me çështje shtetërore dhe nuk do të heqë dorë nga rolet e tij kushtetuese si kreu i shtetit, njoftoi Pallati.

Sipas njoftimit, diagnostikimi me kancer nuk është i lidhur me trajtimin për probleme me prostatën që Charles iu nënshtrua së fundmi. Pallati nuk njoftoi se nga çfarë forme e kancerit është prekur monarku 75-vjeçar.

Pallati Bakingam tha se "është vërejtur një çështje tjetër shqetësuese"



gjatë trajtimit që Charles bëri muajin e kaluar për prostatën, kur ai qëndroi tre net në një spital në Londër.

"Testet diagnostikuese kanë identifikuar një formë të kancerit", tha pallati.

Mjekët, sipas njoftimit, kanë këshilluar Charlesin që të shtyjë detyrat e tij publike. Pallati tha se mbreti britanik është pozitiv lidhur me trajtimin e tij dhe shpreson që t'iu kthehet detyrave publike sa më shpejt që të jetë e mundur.

Charles u bë mbret në shtator të vitit 2022, pas vdekjes së nënës së tij Mbretëreshës Elizabeth II, e cila vdiq në moshën 96-vjeçare.

## SHBA, ARMË BËRTHAMORE NË ANGLI REAGONË RUSËT: DO MARRIN MASA KOMPESUESE

Janë dokumentat e Pentagonit atyre që media britanike i referohet sipas të cilave Washingtoni po planifikon vendosjen e mbushjeve bërthamore në tokën britanike me një fuqi tre herë më të fuqishme se bomba e Hiroshimës.

Një lëvizje e tillë ndodh pas 15-vjetësh për t'i kundërpërgjigjur kërcënimit rus. Në bazë të

dokumentave zyrtare nga Pentagoni baza e re e Forcave ajrore britanike në Lakenheath, në Suffolk, në juglindje të Anglisë ose 75 milje në verilindje të Londrës, do të jetë vend dislokimi i bombave bërthamore të modelit B61-12.

Hera e fundit kur amerikanet kanë stacionuar mbushjet bërthamore në tokën britanike daton në vitin 2008, kur gjykohej se rreziku rus nga

Lufta e Ftohtë ishte në rënie.

Ndërkohë ruset janë kundërpërgjigjur përmes zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme se Moska do të ndërmarrë kundërmasa kompensuese.

Këto plane ndodhin në kuadër të një plani të gjerë të Aleancës së NATO-s që synon zhvillimin dhe modernizimin e qendrave dhe vendndodhjen e lëshimeve të armëve bërthamore si

kundërpërgjigje ndaj tensioneve në rritje mes Perëndimit dhe Kremlinit.

Vendosja e pajisjeve si mburojat balistike apo ndërtimi i ambienteve për ushtarët amerikan në këtë bazë ushtarake britanike do fillojnë në muajin qershor.

Baza e Forcave Ajrore Mbretërore britanike ka qene një nga vendet ku mbaheshin armët bërthamore dhe në vitin 2022 ka pasur protesta nga aktivistët.

Këto lëvizje dhe kjo retorikë të kujton vitet e Luftës së Ftohtë dhe ishin lëvizje të tilla frenuese që garantuan paqen në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore deri në rënien e Perdes së Hekurt më pas. A.M

## A DO TË BASHKOHEN DY IRLANDAT? NACIONALISTJA E SINN FEIN BËHET KRYEMINISTRE E IRLANDËS SË VERIUT

Irlanda e Veriut tashmë ka një kryeministre nga republikanet ose nacionalistët që janë kundër sundimit nga britanikët, por e kanë ndarë pushtetin me unionistët që janë partia e dytë momentalisht, e që janë pro lidhjeve me Londrën.

Të dyja, si kryeministrja nga Shin Fejni anti-britanik, ashtu dhe zëvendës kryeministrja nga unionistët, pro-lidhjeve me Londrën kanë kompetenca të njëjta. Por marrja e postit kryesor të Ekzekutivit nga krahu politik i ish-Ushtrisë Republikane veri irlandeze, IRA, është ngjarje historike, pasi gjithçka ndodh pas 103 vjetësh, që kur Irlanda e Veriut, sipas disave u nda nga Irlanda, disa te tjerë, thonë se dëshiron te rinte me tej nën sundimin britanik.

Kryeministrja e re Michelle O'Neill, nuk vjen vetë nga një e kaluar ushtarake dhe është yll i mediave sociale. Ushtria Republikane Irlandeze luftojë kundër sundimit britanik që nga viti 1922 dhe është kundër idesë se një Irlandë të ndarë dhe refuzoj të

merrte vendet në parlamentet veri irlandeze të ndara.

Po gjithçka ndryshoj pas Marrëveshjes së të Premtes së Mirë në vitin 1998 në kohën e ish-kryeministrit britanik Toni Bler. Sot Shin Fejni krahu politik i IRA-s argumenton se pjesëmarrja në një qeveri me kompetenca te deleguara nga Londra në Belfast është pjese e rrugëtimit drejt ribashkimit me Republikën e Irlandës.

Kryeministrja e re e nacionalisteve veri irlandez që kërkojnë ribashkimin e dy Irlandave njëra anëtare e BE-se dhe tjetra, pjese e Mbretërisë së Bashkuar jashtë saj, thotë se do jete kryeministre e te gjithëve, në një vend ku me mijëra kanë humbur jetën në konflikte përgjakesh në Irlandën e Veriut.

Ardhja në pushtet për Kryeministren e re mund të jetë pjesa më e lehte, por qëndrimin në lartësinë e dëshirës dhe pritshmërive nga të dyja palët e konfliktit, mund të jetë një sfidë akoma më e madhe.

## ARBEN MANAJ

Sa here shikoj lajmet shqiptare gjithëandëj Shtatlartesia e tij! Demin me te madh demokracise shqiptare ja ka bere ky njeri qe ka blere gjithshka ne ate vend, cdo pushtet, dhe erdhi ne emer te ndryshimit dhe beri tere keto mandate me keq sesa parardhesi i tij edhe pse vinte nga zeja jone, publicitika per te cilen i vinte shume keq sesi ishte katan-disur ne kohen e non-grates!!!

Nje autokraci me xhepa te thelle qe nuk ndryshon aspak nga koha e Berishes! KRY-EREDAKTORI i Shqiperise e realizon kete permes nje sistemi gebelsian dhe kontrolli absolut te axhendave mediatike!

Ka blere gjithkend dhe gjithshka ne media! Dhe media ka nder mekatet me te medha ne kete autokraci, pasi eshte vetlejuar te blihet shemtueshem!

Keqardhje per ata qe punojne ne te njejtin zanat si une, por i mirekuptoj se kane familje per te mbajtur me buke!

Por jo deri ne kete dexe dhe hengert dreqi! Ne emer te vetrespektit ua them, se do ua kujtojne nje dite lepirjen ndaj atij, dhe do turperoheni, e qe ne thelb Sulltani, orgazmo-

## KRYEREDAKTORI I SHQIPËRISË



het nga vetposhterimi dhe poshterimi qe ju ben ne delirin e narcizmit te tij, por edhe ne emer te demokracise post-industriale qe nuk funksionon me kulte individi alla Erdogan apo alla Putin!

Gjithshka shume larg vlerave dhe praktikave perendimore te gazetarisë dhe medias si pushtet mjaft i rendesishem si ne kete vend ku jetoj dhe raportoj!

## DAUT DAUTI

Unë, por edhe opinioni publik në Kosovë, njihemi me Besnik Mustafajn që nga fillimi i vitit 1991. Në janar të atij viti Besniku filloi të shkruante në revistën KOHA dhe më vonë në ZERI ku shkruaja edhe unë. Kjo ka qenë koha e fillimit të ndryshimeve në Kosovë dhe Shqipëri. Ne në Kosovë kishim një nevojë apo etje të madhe që të merrnim vesh se çka po ndodhte në Shqipëri dhe si do të ndryshojë ky vend.

Dhe, tashti, për herë të parë, po informoheshim nga një gazetar dhe analist i pavarur nga Shqipëria e jo përmes kanaleve zyrtare të mëparshme, që në fakt ishin propagandë komuniste që e mbante të fshehur të vërtetën.

Besnik Mustafaj me shkrimet e tija e hapi një dritare përmes së cilës ne shikonin zhvillimin politik dhe kulturor në Shqipëri. Ky ka qenë takimi jonë dhe i imi i parë me Besnikun që u bë përmes shkrimeve. Shkrimet e tija zgjonin interesim të madh. Ka qenë e zakonshme që në mesin tonë të gazetarëve, por edhe më gjërë, të parashtrohej pyetja: çka ka thënë Besniku?

Besniku gjithmonë ka pasur çka të thotë, si atëherë në këto dy revista të Kosovës dhe tjerat në Shqipëri, sikur edhe më vonë në diplomaci dhe letërsi ku u angazhua më shumë për të dhënë kontribut të pazëvendësueshëm.

Njeriu i dytë për të cilin dua t'i them disa fjalë, poashtu shkurtimisht, është personazhi kryesor i romanit 'Fati i Marrë'.

Ai është Benjamin Disraeli, njëri ndër politikanët apo burrshtetasit qendrorë në historinë e Britanisë së Madhe, sikur edhe në letërsinë e këtij vendi.

Disraeli në rininë e tij ka qenë shembull tipik i dështimit të njeriut. Ai shkoi në shkollat private, studjoi drejtësinë dhe si një i ri tejet i talentuar, u kualifikua për 'barrister' (avokat). Por, e braktisi këtë profesion shumë shpejt.

Pastaj, e nxorri gazetën 'The Representative' me qëllim që t'a konkurronte gazetën e famshme 'The Times', por dështoi pas 6 muajve. Pastaj, e provoi fatin në fushën e biznesit duke investuar një shumë të madhe të parave në industrinë e minierave në Amerikën Latine. Dështoi edhe këtu.

Por, Disraeli kishte vendosur që të përparonte në shoqëri duke dalur nga rrethi i shtresës së mesme dhe për të hyrë në atë të lartë. Përkundër origjinës që i qëndronte si pengesë, ai nuk dorëzohet dhe ndërmerrte iniciativë të reja dhe kështu e shkroi romanin e tij të parë 'Vivien Grey'. As këtu nuk pati sukses, por u bë i njohur

## FATIN QË NUK E PATI SHQIPËRIA



realativisht.


Në vitin 1830, si 26 vjeçar, Disraeli vendosi të shkonte në Shqipëri dhe t'i vizitonte vendet tjera të Perandorisë Otomane.

Ai këtë vendim e mori jo për shkak se kishte shpirt të avaturistit, por për shkak se atëherë ishte në modë për intelektualët dhe aristokratët britanikë ta vizitonin territorin otoman. Shqipëria në Britani ishte popullarizuar për shkak të Byronit. Disraeli ishte ndër adhuruesit më të mëdhenj të Byronit dhe për këtë arsye erdhi në Shqipëri.

Disraeli, si konservativ që ishte, do të vinte në Shqipëri me një qëllim: që t'i bashkohej ushtrisë otomane në luftë kundër shqiptarëve dhe grekëve. Këtë qëllim ia forcuan edhe më shumë oficerët britanikë në Maltë, që ishte stacioni kryesor i tyre në Mesdhe.

Kur Disraeli mbërrini në Korfuz, që poashtu ishte territor britanik, zyrtarët e këshilluan që të priste edhe disa ditë dhe pastaj të kalonte në Shqipëri për shkak të trazirave. Dhe, kështu, Disraeli nuk mori pjesë në luftë siç kishte planifikuar.

Por, Shqipëria me natyrën dhe historinë e saj, sikur dhe shqiptarët me karakterin e tyre, ia ndryshuan mendjen Disraelit. Sa qëndroi në Shqipëri, Disraeli shprehu simpati për shqiptarët dhe e kuptoi gjendjen e tyre. Mbi



të gjitha e kuptoi dallimin mes shqiptarëve dhe grekëve, të cilin kufi e kishin mjegulluar me qëllim filohelenët në Britani të Madhe. Kjo ishte një njohuri që atij më vonë, pas gjysmë shekulli, do t'i ndihmonte në Kongresin e Berlinit.

Pas kthimit në shtëpi, Disraeli kishte ndryshuar shumë. Hyri në politikë, u zgjodh deputet i partisë konservative, ministër i financave (edhe pse kishte borxh), e fitoi garën për udhëheqës të Partisë Konservative, u zgjodh dy herë kryeministër dhe u bë kryeministri më i dashur i mbretëreshës Victoria.

Pas kthimit nga Shqipëria, Disraeli e shkroi romanin 'The Rise of Iskandar' të cilin e botoi më 1833.

E kishte dëgjuar legjendën e Skenderbeut ndër shqiptarët dhe kjo ishte arsyeja që e shkroi këtë roman. Duhet theksuar se ky është romani i parë i shkruar për Skenderbeun dhe këtë fakt e hasim të diskutuar në distopinë 'Fati i Marrë'. 'The Rise of Iskandar', pothuaj pas 200 viteve është përkthyer në shqip nga Mal Berisha, i cili edhe është personazh në Fatin e Marrë si inspiruesi kryesor për autorin, Besnik Mustafajn. E ndjej veten të nderuar, pasi që edhe unë i kam shërbyer autorit si inspirim dhe në këtë roman jam i paraqitur si personazhi 'Historiani DD'.

Poashtu, kisha nderin që me rastin e promovimit të romanit që u bë në Tiranë, të flisja në panel për romanin. (Kishte kohë që nuk kisha folur para një audience aq të lartë.) Për diskutim apo analizë, 'Fati i Marrë' mund të ndahet në dy pjesë. Por, në të dy pjesët autori e përcjellë vijën e narracionit duke e patur parasysh se si do të duhej të ishin zhvilluar ngjarjet në mënyrë që Shqipëria të pavarësohej më herët dhe si një tërësi e plotë etnike. Ndoshta kjo gjë do të bëhej sikur Skenderbeu të martohej me Idunën dhe Disraeli me Hanën.

Pra, në pjesën e parë të 'Fatit të Marrë', Besnik Mustafaj e korigjion romanin e Disraelit, 'Naltësimi i Iskanderit' duke e paraqitur ngjarjen se si do të duhej të ishte zhvilluar në mënyrë që punët të shkonin për së mbari. Njësoj është edhe më pjesën e dytë, por në këtë rast kemi të bëjmë me atë se si do të duhej të kishte vepruar Disraeli. Por, ngjarja, duke u sjellur rreth boshtit dhe në një strukturë të lakmueshme, paraqet hulumtimin e vijës së ndikimit që ishte krijuar për pavarësimin e Shqipërisë, e cila ka kaluar te Disraeli e deri te mbretëresha Victoria. Ky është fati që nuk e kishte Shqipëria.

Në rastet e promovimeve dhe recensioneve të romaneve nuk është e udhës që të spjegohet tërësisht narrativa. Por, ajo që duhet të thuhet në këtë rast është fakti se Besnik Mustafaj është i pari që e ka sjellur në mënyrë të suksesshme frymën politike dhe rolin britanik si temë primare të një romanit në letërsinë shqipe.

Më në fund duhet bërë me dije se Disraeli në Britani të Madhe është i njohur edhe për thëniet e tija. Është shënuar dhe përsëritet shpesh edhe sot se Disraeli në lidhje me romanet, ka thënë: 'Kur dua ta lexoj një roman të mirë, e shkruaj vet'.

Besnik Mustafaj e ka përcjellë këtë thënie apo këshillë të Disraelit. Besniku me siguri ka dashtë ta lexojë një roman të mirë për Disraelin. Prandaj, e ka shkruar vet.


KIM MEHMETI

## EDHE JUGOSLLAVIA PATI PRESIDENT SHQIPTAR, POR SHQIPTARËT NUK E DONIN!

Nga gjithë shtetet e dala nga ish - Jugosllavia, Maqedonia më së shumti i ka trashëguar 'tiparet' e nënës që e lindi. Si e tillë ajo edhe ndërtohet sipas formulave të ish - Jugosllavisë, në të cilin nuk ishte e rëndësishme përmbajtja, por ikebana politike.

Pra njësoj si asokohe kur sa më shumë dobësohej lidhja mes popujve të federatës së Titos, aq më shumë forcohej 'vëllazëria' mes elitave politike shumetnike që e drejtonin atë, edhe në Maqedoninë e sotme ndodhë që sa më keq ndjehen qytetarët dhe e braktisin atë, aq më bashkëpunues mes veti janë elitat partiake që e zhvatën vendin.

Dhe sot kur në Ballkan pakësohet numri i shqiptarëve e shtohet numri i kryeministrave shqiptarë, dikush aq i përbuzë shqiptarët e Maqedonisë sa i shpërfaq të paaftë ta kuptojnë se një shtet nuk matet me atë sa i mirë është



për pushtetarët e vet dhe mysafirët e tyre, por sa i përshtatshëm është për qytetarët dhe rinin që banon në të.

Por megjithatë, sado që me pamje të rrejshme ta fshehësh të vërtetën, me asgjë nuk mund ta mbulosh mungesën

e zërave fëmijëror nëpër shkollat dhe vendbanimet shqiptare si dhe, të vërtetën se ka një Maqedoni parajsë ,

ku jetojnë hajdukokratët e BDI-së dhe një Maqedoni të pabanueshme për familjet shqiptare.

Dhe në një dy-Maqedoni të tillë nuk vlen gjë cilido burrështetas që majmet në grazhdin e shtetit dhe që harron se mediat e paguara në Tiranë e Prishtinë të mundësojnë që përkohësisht të dukesh më shumë seç je, por kurrë nuk do munden ta fshehin të vërtetën se BDI-ja është e paarritshme vetëm në 'dëbimin' e të rinjve nga Maqedonia.

Andaj gabojnë të gjithë ata që bëhen pjesë e paradave që shënojnë arritjet e BDI-së, duke besuar se shqiptarët e këtushëm janë aq budallenjë sa mos e dinë se sot askush nuk të lëvdon pa e paguar as kur e meriton atë, e lëre më kur je injorant politik, siç janë drejtuesit BDI-së, të partisë që për shumëçka do mbetet kancer politik i shqiptarëve të Maqedonisë.

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946

## POROSISNI kartat e biznesit tuaj

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Na kontaktoni:

020 7018 7929 073 4066 5946 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT



# AKOMA NUK KENI NJE WEBSITE?

Akoma nuk jeni  
regjistruar në Google?

**Dotech**  
website 

*The* **Albanian** 



**"If your business  
is not on the internet  
then your business will  
be out of business"  
BILL GATES**

**Krijo websitin tënd!**

- Business Cards
- Banners
- Video Marketing
- Logos
- Etc



020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545

**PËR ÇDO KONSULTIM  
MUND TË VINI NGA  
ZYRAT TONA**

Adresa e zyrave  
30 Avenons Road,  
London E13 8HT

GENC BURIMI

Kur pashë intervistën-rrefim dy orë e gjysëm të ish-zëvendës Kryeministrit Arben Ahmetaj, instiktivisht, një tjetër imazh televiziv iu mbiviu, të parit. Një dokument arkive në youtube, ku Kadri Hazbiu me pranga, qëndron në këmbë para trupës gjyqësore, me çehre prej mermeri dhe të mplantur para kohe. Ish-ministri i brendshëm i Enver Hoxhës, thajse numri dy i ish-regjimit diktatorial shqiptar, me një ton gjysëm të mposhtur e gjysëm të revoltuar i drejtohej gjykatësit popullor me këto fjalë: «Më kanë torturuar ç' njerëzisht që të pohoja të pavërteta!». Dhe gjykatësi i regjimit që ja kthente: «po ju vetë keni qenë Ministri i atij dikasteri që thoni që ju paska torturuar.

Edhe ju i torturonit të tjerët?!» Midis ndjenjës së mëshirës nga njera anë për të mjerin Kadri Hazbiu, pasi kurrë nuk mund të pajtohesh me akte që prekin dinjitetin njerëzor, por dhe ndjenjës së dhimbjes së pakufishme nga ana tjetër për ato qëndra e mijëra viktimë të pafajshme që ai xhelat dhe ai regjim, të cilit i shërbeu, jo vetëm torturuan por dhe vranë pa mëshirë, një mendje e kthjellë e bën vetvetiu përzgjedhjen. Kush duhet të të dhimbset më shumë, populli viktimë e politikës apo politikanët viktimë të politikës?

Arben Ahmetaj, i shërbeu deri tani vonë, pushtetit të tretë rradhazi në Shqipëri, «Rilindjes», që zaptoi vendin mbas një gjysëm shekulli komunizëm, pasuar prej një çerek shekulli pëdëizëm. Vetëm në dhjetë vitet e fundit të «Rilindjes» së Edi Ramës dhe Arben Ahmetajt e kompani, janë mbi një milionë shqiptarë që kanë lënë me lemeri vendin për shkak të kësaj lemerie kleptokratike të pushtetit të «Rilindjes» që ish-zëvendës kryeministri e pikturoi në intervistën e tij, si të ishte një tablo e Dantes.

Rilindja e zotit Arben Ahmetaj që ka mbërthyer Shqipërinë me metastazat miliardë eurosh të koncesioneve të monitoruara nga Ministria e Financave ka arritur rekord historik të largojë në një dekadë më shumë shqiptarë sesa të tre pushtuesit bashkë të së kaluarës, otomanët, fashistët dhe nazistët. Pa llogarit viktimitat që lënë kokat në ujërat e akullta të la Manshit. Tek një pjesë e madhe e shqiptarëve që patën rastin të ndiqnin Arben Ahmetaj në tv nga Zvicra që vazhdon të strehojë përtej parasë së pisët edhe politikanët e parave të pista, vetëm një mendim i trishtë dominon: çfare (s) i paskeni punuar këtij vendi mor bastardë?!

Vetë ai, Arben Ahmetaj kur ta rishohë në replay monologun e tij, do të arrijë në të njëjtin konkluzion: si qytetar ndjehesh i përcudnuar dhe i poshtëruar kur dëgjon se çfarë është luajtur dhe vazhdon të luhet në kurrizin e mbarë një populli nga një bandë mafioze në pushtet nën heshjen shurdhuese të një drejtësie që ka dhënë dorëheqje dhe merret me mizat kur buajt i janë vër-sulur me brirë plaçkës publike.

Personazh negativ por që bën pyetjet e duhura

## ÇFARË (S) I PASKENI PUNUAR KËTIJ VENDI MOR BASTARDË?!



E megjithatë, s'mund të dëgjoje rrefimin e Arben Ahmetaj pa një grimcë mëshire që duhet kemi ndaj çdo qenieje njerëzore që vuan në mishin e saj. Kjo e ndan civilizimin nga barbaria. Një rend i civilizuar nuk i'a nënshtron mëkatarin barbarisë siç e bënte Mesjeta dhe siç ndodh në regjimet autoritare. Kërcënuar personalisht me vdekje dhe deri tek fëmija e tij, Arben Ahmetaj nuk pushoi së bëri aluzion se një ditë mund ta zhdudin, se kish marrë parasysh gjithçka dhe se vdekja ishte tashmë pjesë e pandashme e skenareve të tij për të ardhmen. Të dukej sikur dëgjoje Prigozhinin.

Por ndonëse në Rusinë diktatoriale dhe pa drejtësi këto fenomene nuk habisin, si është e mundur që në Shqipërinë e drejtësisë së perëndimorëve një ish-zv.kryeministër rrefen se ka marrë tri herë kërcënime për vdekje, duke treguar vendin dhe personat, dhe asnjë hetim mos të jetë ndërmarrë? Ku janë SPAK-u, apo prokuroria e Tiranës, apo shërbimet e inteligjencës? Si mund të lihen dhe banalizohen kërcënimet me vdekje ndaj atyre që kanë ushtruar autoritet publik dhe drejtësi mos të tregojë dhëmbët? Një pasivitet që tregon se edhe ai shqiptari i thjeshtë pa pushtet mund të shqetësohet legjitimisht për fatin e tij dhe të fëmijëve të tij. Kërcënime të tilla mori para pak kohësh nga mafia e drogës Kryeministri i Hollandës dhe anëtarët të familjes mbretërore të Hollandës.

U shokua mbarë Perëndimi dhe masat e nevojshme u morën si në hetime ashtu dhe për mbrojtjen e personave të kërcënuar sepse bëhet fjalë për besimin që duhet të ketë opinioni tek organet që duhet të garantojnë sigurinë fizike të secilit. Por ne Shqiperi, drejtësia deshmohet se funksionon si politika: po ishe i poshter dhe ke tradhetuar kupolen e pushtetit, dhe ne djall te shkosh askush nuk do levize as gishtin e vogel. A është drejtësi normale kjo e cila 48 ore pas atyre rrefimeve që degjuam mos të beje asnjë prononcim ne lidhje me tentativat për vrasje që degjuam nga goja e ish-Kryeministrit?

Se dyti, 48 ore pas intervistës – lum te ish ministrit te Financave, nuk ka asnjë prononcim nga sistemi i drejtësisë ne Shqiperi ne lidhje me mbi-abuzimet

me fondet publike te denoncuar nga zoti Ahmetaj.

Ahmetaj mund të jete nje personazh negativ dhe keqberes per drejtësinë dhe shumicën e shqiptarëve që vuajnë ende në kurriz pasojat e politikave të tij si ish-shtetar i larte, por kjo s'mund të kthehet kurrsesi në pretekst që të behet veshi i shurdher ndaj pyetjeve të drejta dhe të goditura që shtrihen. Asnjë drejtësi normale në një vend normal në Perëndim nuk do i mbyllte sytë dhe veshet ndaj rrefimeve të nje te « penduari ». Si është e mundur që një gazetar arrin dhe e gjen te aratururin, i fikson atij takim, e ben te flase me ore te tera, ndersa SPAK-ut as qe intereson te dije se çfare di Ahmetaj. Kur behet fjala per interesin e Amerikes, e pame sesi nje prokuror amerikan nuk pertoi dhe shkoi deri ne Vjene per te takuar shqiptaret e Mac Gonigalit se çfare kishin per te thene ata qe mund te vinte ne rrezik sigurine kombetare te Amerikes. Ndonese ajo rezultoi nje fluske sapuni, ky eshte roli i drejtësisë, te mos neglizhoje asnje piste kur behet fjala per dosje me intrinse kombetar. Si shpjegohet qe Spak shpalos me shume energji dhe masa qe mos t'i shpetoje asnje grimce informacioni nga nje Berishe apo nje Malltez ne nje dosje te 15 viteve sh ku paraja publike qe mund te rikuperohet eshte afer zeros, dhe ky Spak nuk tregon zellin me te vogel te mesoje se çfare di Ahmetaj ne nje dosje ku shqiptaret mund te rikuperojne shuma kolosale te dala nga djersa e tyre?

«Ku jane 60 milione eurot e incineratorit te Tiranës», pyeti disa here ne interviste Ahmetaj. Bente sikur nuk e dinte. Po edhe sikur ta dije, problemi nuk eshte aty, por tek indiferenca absolute e SPAK keto dy vite, per te mos levizur nje qime qe t'i hyje me themel kesaj mega vjedhjeje ne historine e kombit shqiptar. Thone qe Spak po heton, por po na rezulton e kunderta. Eshte media qe po heton. Inisiativa e nje Cim Peke eshte nje shuplake e hidhur per drejtësinë e Perendimoreve ne Shqiperi. Nje shuplake tjetere po jepet dhe nga investigimi i nje grupi pune te opozites pa asnje mjet publik, se kush jane aksioneret qe fshihen mbrapa 100% te kapitalit te firmes se incineratorit te Tiranës qe jo vetem gllaburuan

mbi 100 million euro per nje objekt qe nuk u ndertua kurre, por keta aksionere okulte vazhdojne dhe arketojne si ne kazino plote 80 mije euro ne dite per djegie plehrash qe detyrimisht pa djeges nuk mund te digjen kurre. Duke cituar investigimin e opozitarit te bashkise se Tiranës Belind Kelliçi, Arben Ahmetaj u thote me te drejte prokurorëve te Spaku-t pse nuk e beni ju kete hetim?

Per me teper qe emri i aksionerit kryesor te incineratorit fantazem egziston, shqiptaro-zvicerani, Blerim Hoxha qe mban 40% te aksioneve sipas Ahmetajt. Ai shtoi dyshime te forta se politikane te Tiranës kane nga ana e tyre 20% te aksioneve te fshehura ne nje parajse fiskale, aty ku mund te kene shkuar dhe «60 milionet» e zhdukur. Pse duhet te hetoje per keto Belind Kelliçi? Pse duhet te rrefeje per keto Arben Ahmetaj? Pse nuk e ben prokuroret e Spak, ata qe paguhen nga shqiptaret me mijera dollare euro rroge ne muaj pikerisht per te nxjerre ne shesh te verteten. Çfare eshte ky shou i perditshem me politikane te opozites nen hetim apo ne arrest, nderkohe qe paralelisht pikojne nga xhepat e shqiptarëve 80 mije euro vjedhje e pastert per nje sherbim publik qe nuk ka egzistuar kurre?

A nuk duhet te japin llogari ata qe kane firmosur me doren e tyre per incineratorit fantazem dhe per nje « sherbim publik » te munguar se ku po shkojne parate e shqiptarëve? Ju premtua shqiptarëve pandeshkueshmeria. Veçse ajo nuk eshte gjekundi. Nje pjese e atyre qe dyshohen se kane gisht ne skemen e zhatjes se shqiptarëve me incineratore fantazem gjejne azil jashte dhe japin intervista te llojit «hajde t'u tregoj sesi u vodhet» (Ahmetaj, Mertiri...), ndersa pjesa tjetere te dyshuarve qe qendron ne Shqiperi, ato «dy Qendrat e Tiranës» siç i quan Ahmetaj, rrjedhin dite te lumtura besimplote se hetim mbi ta nga ky Spak jo vetem qe nuk do kete, por as kureshtje minimale nga drejtësia se ku kane perfunduar milionat e vjedhura nuk do te kete. Ndaj pyetja shtrohet sic e shtron Ahmetaj dhe para tij opozita: kur do te filloje te ngreje pyetjen Spak se ku ka kane avulluar te pakten 60 milione euro nga mos ndertimi i incineratorit fantazem te Tiranës? Si ne nje skenar trilleri hollivudian; edhe ne momentin qe ti ben kete pyetje ne kohen e shkuar, ku kane ikur parate, vjen menjehere pyetja ne kohen e tashmen: ku po shkojne tani qe flasim mbi 2 milione euro ne muaj (80 mije euro ne dite) qe paguhen aktualisht per te djegur plehrat e Tiranës ne nje djeges qe nuk eshte ndertuar.

Vite me vonë, gjeneratat e ardhshme te shqiptarëve do te qeshin hidhurazi me kete histori: kaq idiote paskan qene babagjysherit e tyre qe blinin shtrenjte nje shishe transparente me qumesht dhe brenda e shihnin mire qe s'kishte qumesht? Si mund te paguash

per djegie plehrash ne nje djeges qe nuk egziston? Fakti eshte se gjenerata e sotme nuk eshte aspak idote por e tradhetuar nga «elitat» vendase dhe nga Perendimi qe vazhdon t'u thote ketyre shtetareve dhe kesaj drejtësie, vazhdoni keshtu se mire e keni. Si mund te kerkojne shqiptaret nga drejtësia e tyre perse po ua shesin shishen bosh, kur SPAK as nuk e sheh se shishja eshte bosh? Si duam ne qe SPAK-u te kerkoje 60 milionet, kur as nuk ngren minimalisht pyetjen a jane zhdukur 60 milione, me shume, me pak...? U desh qe nje e vertete kaq e thjeshte te dale nga goja e atij qe ka qene brenda sistemit te vjedhjes, per t'u ndergjegjesuar se çfare epoke surrealiste po perjeton Shqiperia me drejtësinë e saj «te re» e supozuar te bente kerdine ne krahasim me drejtësinë e vjeter.

Surrealizmi nuk perfundon tek «ku ka shkuar 60 milionet». Ate e gjeje te shtrire nga fillimi deri ne fund te intervistes-lum se Arben Ahmetaj e cila do te kishte vazhduar gjithë naten sikur Cim Peke mos t'ja kishte nderprere fjalen pas plot 2 ore e gjysëm bashkebisede. Le te kujtojmë me kete rast ate pyetjen tjetër halicinante qe ngriti Ahmetaj ne adrese te Spak-ut. Le ta përfrazojmë. Prokurorë te Spak-ut, a është e vertete se ka ndërmjet jush qe kane marre vila per dhurate, nje prokuror ka marre nje vile komplet falas e nje tjetere me gjysëm çmimi? Behet fjala sipas medjave per vete drejtuesin e Spak-ut, Altin Dumani te cilit nje organizem fetar i paska dhuruar falas nje vile, dhe prokurori tjetere, i famshmi Arben Kraja qe ka nje vile ne gjirin e Lalzit te pajustificuar me rrogat qe merr por qe ia paskan bere dhurate me gjysmen e vleres. E imagjnojme çehren e bezdisur te ketyre dy prokurorëve nese e kane degjuar Ahmetajn live, me ate shprehjen ne fytyre: «ç'ja varni thashethemeve te nje te korruptuari te arraturisur». Veçse nuk ka rendesi kush e ben pyetjen, rendesi ka pergjigja! A është thashethem apo është e vertete akuzat qe ngriti Ahmetaj ndaj organit te hetimit? Spaku heton, thuhet. Po vete Spakun kush e heton? Shqiptaret paguajnë me taksat e tyre nje tjetere institucion ne galaksine e institucioneve te panumerta te reformes se drejtësisë. Ky «leukocit», Samaritani i drejtësisë qe mbroka popullin nga mekakat e vete drejtësisë emertohet me tre germa: ILD ose Inspektoriati i larte i drejtësisë. As kete institucion sa te respektohet aq dhe anonim nuk e degjuam te beje ndonje deklarate 48 ore pas ketij «thashethemi» kaq te rende nga ana e ish – zv Kryeministrit kur tha se ai po hetohet per vleren e pllakave majelike dhe te tubave te ujit ne vilen e ish-gruas se tij nga nje Prokuror qe per ironi te fatit ka vete nje vile qe nuk e justifikon dot... Nese ILD nuk hap nje anketim dhe urgjentisht per vilat e supozuara te Dumanit dhe Krajes, qofte dhe per te bere nje pergenjeshtrim, per shqiptaret kjo do te jete me shume se nje ofendim, nje poshterim. A do te shnderrohet valle ndonjehere ne Shqiperi Vox Populi në Vox Lei? Per momentin, reforma aq e reklamuar ne drejtësi, le nje shije te hidhur padrejtësie.

## DITMIR BUHATI

Viti 2024 duket që do të shënjohe nga luftërat dhe zgjedhjet, të cilat do të ndikojnë në fatin e një pjese të mirë të popullsisë së botës. Në kuptimin e sigurisë, pikënisja e vitit 2024 mund të jetë 7 tetori i vitit të kaluar kur u rindez konflikti i përgjakshëm në Lindjen e Mesme apo 24 shkurti i vitit 2022 kur Rusia vendosi të pushtojë Ukrainën. Këto dy konflikte të mëdha kanë sjellë një ndarje të re botës.

Pas pushtimit të Ukrainës, Perëndimi udhëhoqi një shumicë shtetesh në Kombet e Bashkuara, që dënuan agresionin e pashembullt rus. NATO rifitoi arsyen e ekzistencës së vet, përshtati konceptin e strategjisë dhe zgjeroi perimetrin e sigurisë në Europë duke mikpritur anëtarë të rinj. Elementi më befasues i historisë ishte përgjigjja e BE-së. Historia e paketës së sanksioneve ndaj Rusisë, përfaqësoi politike me afrimin e Ukrainës në tryezën e bisedimeve për anëtarësim në BE, ndihma ekonomike dhe ushtarake ndaj saj është dëshmi e unitetit të BE-së, përtej pritshmërive të zakonshme.

Pasi nuk duhet të harrojmë faktin se Rusia ka qenë tradicionalisht një nga elementët më përçarës dhe polarizues në politikën e jashtme europiane. Rindezja e konfliktit të përgjakshëm në Lindje të Mesme e përmbysi epërsinë e perëndimit përkundrejt pjesës tjetër të botës, për shkak të ndarjeve katastrofike brenda BE-së dhe vetë Perëndimit. Dhe askund kjo nuk ishte më e dukshme se sa në votimet që u zhvilluan në OKB, ku Perëndimi ishte i përçarë.

Ky konflikt, i cili shoqërohet me vërshimin e refugjatëve në kufijtë e BE-së ka një ndikim të madh në politikën e brendshme europiane. Shtu këtu nxijtën e valëve të reja të antisemitizmit dhe islamofobisë në Europë, sikundër kërcënimin në rritje të terrorizmit. Dy luftërat e mësipërme sollën edhe një rreshtim të ri për sa u përket prioritetëve. Për SHBA-të në veçanti, sigurimi i mbështetjes së mëtejshme ushtarake ndaj Ukrainës ka kaluar në plan të dytë, për shkak të konfliktit në Lindje të Mesme. Kjo shihet qartë edhe nga intensiteti diplomatik i pesë vizitave të sekretarit amerikan të shtetit në Lindje të Mesme që prej 7 tetorit.

Megjithatë, përfundimi i konfliktit, zgjidhja e qëndrueshme dhe e pranuar nga palët nuk duket në horizont. Cilido qoftë rezultati në terren, një rritje dramatike e radikalizimit mbetet kërcënim kryesor për periudhën në vijim. Hebrenjtë izraelitë e ndjejnë veten të izoluar dhe madje gjykuar, pasi u përballën me dhunën më të keqe kundër tyre që nga holokausti. Ndërsa palestinezët përballen me atë që ata e konsiderojnë krim kundër njerëzimit, pa mundësi për paqe dhe pa perspektivë.

Ndarjet e thella politike mbi konflik-

tin shtrihen në të gjithë Lindjen e Mesme dhe me ndikim në mbarë botën. Izraelitët do të kuptojnë se edhe nëse mund të neutralizojnë Hamasin, ata nuk do të jenë kurrë të sigurt pa një marrëveshje rajonale të sigurisë dhe pa një normalizim të plotë të marrëdhënieve me fqinjët e tyre arabë, duke u mbështetur në Marrëveshjet e Abrahamit. E gjithë kjo nuk do të jetë e mundur pa një rrugë të sigurt drejt një shteti palestinez. Në këtë çështje, mesazhet e takimit të përvitshëm të Davosit ishin disi optimiste, edhe pse nuk duhet harruar se dy vjet më parë askujt prej pjesëmarrësve në Konferencën e Sigurisë së Mynihut nuk ia priste mendja që pas pak ditësh Vladimir Putin do të pushonte Ukrainën.

Sekretari amerikan i shtetit Blinken deklaroi se, “vendet arabe dhe vendet myslimane edhe përtej rajonit janë të përgatitura të kenë një marrëdhënie me Izraelin përsa i përket integritet të tij, normalizimit të tij, sigurisë së tij, çka nuk ka qenë rasti më parë, në mënyrë që Izraeli jo vetëm të integrohet, por të ndihet i sigurt në rajon”. Të njëjtën gjë konfirmoi edhe ministri i Jashtëm saudit, Faisal Bin Farhan, teksa deklaroi se, “vendi i tij mbetet i

përkushtuar ndaj normalizimit me Izraelin me kushte të qarta dhe angazhim për një shtet palestinez”.

Ndërkohë, agonia që sjell lufta në Ukrainë, e cila shënon vitin e dytë të saj, krijon një situatë pasigurie për ukrainasit dhe frustrimi për europianët. Si çështje kyçe për sigurinë, përfundimi i luftës në Ukrainë përbën përparësi për Europën në vitin 2024. Nëse BE-ja nuk mund të sigurojë paqe dhe stabilitet në lindje të saj, konfliktet dhe paqëndrueshmëritë atje mund të përhapen gradualisht drejt pjesës tjetër të kontinentit. Ballkani Perëndimor është një zonë, ku për shkak të konflikteve të papërfunduara që nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, roli përçarës i Rusisë shikohet si kërcënim për stabilitetin rajonal.

Në këtë pikë BE-ja shfaqet anemike, për shkak të mungesës së unitetit në trajtimin e çështjeve të papërfunduara të shtetësisë dhe tolerimit të Serbisë si prishëse e stabilitetit rajonal. Përkundrejt pritshmërive për një kthesë të fortë, e vërteta e hidhur është se Ballkani Perëndimor është po aq larg BE-së në planin politik dhe ekonomik sa ç’ ishte para realitetit të ri gjeopolitik që jetojmë në Europë, pavarësisht

përsëritjes së retorikës për betuese të dyanshme për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, si synim strategjik i dyanshëm.

Serbia nuk u është bashkëngjitur sanksioneve të Perëndimit ndaj Rusisë, duke përforcuar mendimin se Ballkani Perëndimor nuk është një rajon, në kuptimin politik të fjalës dhe as i linjësuar me BE-në. Gjithashtu, në rrafshin ekonomik, hendeku mes rajonit dhe BE-së nuk po zvogëlohet. Edhe nëse BE-ja përmbush angazhimet e saj të fundit të përshkruara në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, e të diskutuara në takimin e udhëheqësve të rajonit në Shkup, nuk ka gjasa të përparojë ndjeshëm në procesin e konvergencës ekonomike midis rajonit tonë dhe BE-së.

Me rritjen e propozuar vendet e rajonit do të marrin gjashtë deri në tetë herë më pak fonde për zhvillim, krahasuar me fqinjët tanë anëtarë të BE-së. Siç dihet, fondet janë të lidhura me standardet dhe zbatimin e rregullave të shtetit të së drejtës, ku vendet e rajonit çalojnë dhe vetë trajektorja e procesit të aderimit në BE nuk vërton një raport të drejtë me ecurinë re-

## PIKA TË ZEZA, APO TË NDRITSHME?



formave. Nga ana tjetër, pak flitet dhe analizohet për transferimin e pasurive të konsiderueshme nga vendet e Europës Juglindore në Europën Perëndimore, pjesërisht për shkak të deficitit të madh tregtar, pagesave të kredive dhe furnizimit me kapital njerëzor.

Thënë ndryshe, raporti i tanishëm politik dhe ekonomik mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, nuk po e bën këtë të fundit më të zhvilluar në aspektin ekonomik dhe as më demokratik nga pikëpamja e jetësimin të vlerave dhe parimeve të demokracisë liberale. Për t’i dhënë fund luftës, familja euro-atlantike duhet t’i tregojë Rusisë vendosmërinë për të ndërmarrë hapa të qartë për të përgatitur Ukrainën për një të ardhme paqësore. BE-ja duhet të ndërgjegjësohet për nevojën e një arkitekture të re të sigurisë europiane, e cila në kushtet e këtij agresioni të pashembullt nuk krijon mundësi që shtete të ndryshme të qëndrojnë në zonë të ndërmjetme, siç është rasti i Serbisë.

Po kështu, premtimet për zgjerimin e BE-së duhen shoqëruar me hapa dhe një afat kohor konkret. Vështruar nga ky kontekst, pyetja që lind natyrshëm është nëse konfliktet e mësipërme mund të kthehen nga pika të zeza në të ndritshme? Viti 2024 do të jetë një vit përcaktues, pasi rreth pesëdhjetë shtete, apo gjysma e popullsisë së botës do të shkojë në zgjedhje, për të kulmuar me zgjedhjet në SHBA. Rezultati i të cilave do të ndikojë në fatin e jo vetëm amerikanëve që do të thonë fjalën e tyre përmes votës. Vladimir Putin nuk ka arsye të shqetësohet, pasi në muajin mars pritet të marrë mandatin e pestë. Në BE dhjetë vende kanë zgjedhje dhe sigurisht që shumëçka do të rrotullohet rreth zgjedhjeve të Parlamentit European.

Edhe Mbretëria e Bashkuar shkon në zgjedhje. Një ndryshim politik atje mund të përshepjetojë shkrirjen e akullit midis Londrës dhe Brukselit. Demokracitë e mëdha aziatike, India dhe Indonezia do të zgjedhin udhëheqësit e tyre gjithashtu. Ekonomitë e tyre me rritje të shpejtë po fitojnë peshë globale në rritje. Në një mënyrë a tjetër, mënyra e adresimit të dy konflikteve kryesore do të varet edhe nga rezultatet zgjedhore në pikat kyçe të botës. Pasi zgjedhjet do të përcaktojnë kursin strategjik për vitet e ardhshme, të cilat duket se do të jenë të stuhishme. Pikërisht për këtë arsye, kemi nevojë për ekuipazhin më të mirë të disponueshëm për udhëtimin përpara.

\*Analiza është botim i fondacionit “Friedrich Ebert”

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni  
regjistruar në  
Google?!

**Për çdo  
konsultim  
mund te vini  
në zyrat tona**

*The* **Albanian**

**Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road  
London E13 8HT**

**Na kontaktoni:**

**020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545**



**NE MUND T'U  
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc

## LUTFI DERVISHI

Në një vend ku procesi i vendimarrjes së... mazhorancës i ngjan një karnavali që sfidon logjikën episodi i fundit ku gardistët pengojnë deputetët e opozitës të hyjnë në sallën e Kuvendit, ngre pyetjen: Kemi të bëjmë me satirë të nivelit të lartë, apo thjesht me një skenë kafkiane? Komisioni i Lartë i Etikës së Kuvendit me votat e shumicës vendosi që të përjashtojë deputetët, të cilët u penguan për të qenë të pranishëm në sallën e Parlamentit.

Një deputet i shumicës që për Bibël ka rregullin dhe përpikmërinë tha se: "Përjashtimi erdhi për shkak se kur u morën mungesat, deputetët në fjalë ishin jashtë sallës së Kuvendit. Pra, mungonin në seancën më të rëndësishme, atë të së hënës së parë të muajit kur diskutohen hallet e elektoratit. Por anëtarët e tjerë të komisionit nuk e trajtuan çështjen si një veprim thjesht teknik. Arsytimi i tyre u ngjan ushtrimeve të vështira të gjimnastikës politike, ku mësimi është si të kapërcesh me një kërcim nga logjika në absurditet. Përjashtimi i deputetëve të opozitës, thotë Komisioni i Lartë i Etikës, nuk është një masë ndëshkuese, por një përpjekje humane për të shpëtuar "Tempullin e Demokracisë" nga shkatërrimi i mundshëm dhe turpërimi publik.

Njeriu për një nder rron. Vendi një Parlament ka! Deputetët e mazho-

## GARDA, SHPËTIMTARJA E OPOZITËS



rancës, të njohur për angazhimin e tyre të palëkundur ndaj etikës, rregullave dhe ligjit, sigurojnë publikun vendës dhe partnerët ndërkombëtare se vendimi i tyre është mishërimi i përsiatjes së thellë dhe respektit të palëkundur ndaj parlamentarizmit. Kushdo që vë në dyshim madhësinë e këtij vendimi është thjesht një mjeran që nuk është zhytur në thellësitë e procesit të tyre "tmerrësish" të menduar. Tani, le të shqyrtojmë të kundërtën e asaj që panë të gjithë "live" në 15 kanalet televizive.

Të mendojmë për një moment të pamendueshmen: Gardistët çmenden dhe lejojnë deputetët e opozitës të hynin në truallin e shenjtë të Kuvendit

– në seancë plenare. Tmerr! Deputetët me emra që tingëllojnë si personazhe të një tragjedie shekspiriane – Bardhi, Noka and co – do të shkaktonin kaos në "Tempullin e Demokracisë". Zhurmë, tym, karrike të përmbysura dhe mos o Zot thirrje kundër qeverisë! Thjesht ky mendim i ka shtirë të dridhurat jo vetëm Komisionit të Lartë të Etikës, i cili besohet se është bastioni i vetëm që ka mbetur në mbrojtje të parlamentarizmit. Në këtë skenar hipotetik përzier me notat e tragjedi-komedisë që na është shfaqur, Komisioni i Lartë i Etikës, si mbrojtës fisnik i virtytit parlamentar, do të detyrohej nga ndenja e lartë e detyrës që t'i pezullonte keqbërësit recidivist opozitarë për 60 ditë/net të plota.

Këtë thotë rregullorja e re e miratuar me unanimet të plotë nga deputetët e shumicës. Imagjinoni ankthin në fytyrat e opozitarëve të mbetur pa punë, pa rrogë dhe më tragjikisht, pa foltoren e dashur të Kuvendit për 2 muaj, për tetë javë, apo 60 ditë, apo 1440 orë. Është thujse shekspiriane – një tragji-komedi me shumë akte. Mirëpo ndërhyrja dashamirëse e gardistëve i erdhi në ndihmë deputetëve të opozitës. Falë kësaj ndërhyrje etike, ligjore, burrërore, po të doni edhe kafshërore të gardistëve tani deputetët e opozitës nuk do t'i gëzojnë privilegjet parlamentare vetëm për 10 ditë dhe jo për 60. A nuk duhet që opozita në vend që të kërcënojë me padë, të falënderojë Gardën?

Vetë gardistët, të pyetur nga Komisioni i Lartë i Etikës pohojnë se veprimi i tyre ishte instinktiv – një dëshirë njerëzore për të mos ndarë deputetët e opozitës nga mbështetësit e tyre që po protestonin vetëm pak metra larg. Po të lejonin deputetët e opozitës brenda, turma e protestuesve do të mbetej pa kokë.

"Por ne si ushtarakë e dimë se më e rrezikshme se ushtria e një armiku më të madh në numër, më e frikshme se një tërmet apo pandemi është për-

ballja me një turmë që nuk ka kokë. Përballja me turmën është fatale. Sot më shumë se kurrë kemi nevojë për stabilitet dhe jo fatalitet".

Gardistët jo vetëm që shpëtuan deputetët nga ndëshkimi, por bënë edhe punën e Policisë së Rendit. Ruajtën qetësinë. Duke mbajtur deputetët të lidhur me elektoratin e tyre, nuk ndodhi asnjë ngjarje e pa këndshme që do të cenonte reputacionin tonë si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat veteran për anëtarësim në BE. Për këtë arsye, gardistët duhen shpërblyer dhe deputetët e opozitës duhet t'i thërrasin mendjes dhe të mos kërkojnë të futen në sallën e Kuvendit.

Ka plot sheshe Shqipëria ku mund të kuvendojnë me veten apo me njerëzit – le ta zgjidhin vetë audiencën. E rëndësishme është që opozita të kuptojë se Garda vepron vetëm në interes të demokracisë dhe parlamentarizmit. \* \* \* Në këtë spektakël madhështor të teatrit politik, ku mbretëron absurditeti dhe arsyeja zë vendin e fundit, nuk mund të mos pyesim veten nëse jemi dëshmitarë të një tragjikomedie apo një çmendurie. Dhe siç kemi bërë ndër dekada, edhe në këtë rast do të zgjedhim të keqen më të vogël.

## ALFRED LELA

Kur pyeta një amerikan, rezident në Shqipëri se, ç' mendon për intervistën e Ahmetajt, mu përgjigj me një kundrapjetje:

Çfarë do të kishte ndodhur në Amerikë nëse, ta zëmë, Nancy Pelosi ose Kamala Harris do të kishin ikur, le të themi në Singapor, dhe prej aty të lëshonin akuza të forta kundër presidentit Biden?

Të paktën një impeachment kundër Biden dhe, më e pakta fare, një reagim i Presidentit, dhe shumë të tjerëve në departamentet e qeverisë amerikane.

Por, nuk jemi në Amerikë dhe nuk ka ndodhur asgjë e tillë.

Komunikimi publik mban si aksiomatike tezën se, në raste krizash apo akuzash, nëse nuk reagon, edhe nëse nuk je fajtor je duke e marrë përsipër fajësinë. Në këto kushte, a është fajtor Rama, apo duke zgjedhur të mos reagojë, ngase nuk e njeh komunikimin publik!?, po merr përsipër një faj që nuk e ka?

Që të jemi praktikë deri në fund faji është i dyllotë. Faji për aktin që ke kryer në kundërshtim me rregullat apo ligjet, dhe faji në të cilin je aktor

## HESHTJA E RAMËS DIÇKA MË THOTË



i dorës së dytë apo tretë, pra bashkë-fajtor, aksesor etj. Ka edhe një lloj të tretë faji, që njihet si fajtor nëpërmjet bashkëshoqërimit apo, në anglisht guilt by association.

Pra, Rama nuk ka faj, por thjesht shoqëria me Arben Ahmetajn e fut në faj.

Nëse ka nga ata që, për të shfajësuar Ramën zgjedhin këtë pistë të tretë, do të kundërshtohen nga logjika.

Së pari, sepse aktori i madh në këtë bashkëshoqërim nuk është Ahmetaj, por Rama. Është ky i dyti shefi i të parit dhe kryeministër i vendit. Pra, në çdo rast është Rama që mund të akuzohet si për faj, si për bashkëfajësi. Faji merr kuptim prej fuqisë apo pafuqisë. Në dyshen e ushtrimit tonë, Rama-Ahmetaj, është kryeministri që e ka fuqinë dhe e ushtron pushtetin, jo e kundërta.

Së dyti, edhe në rastin kur Ahmetaj mund të ketë ngrënë dardha pas sh-

pinës së tij,

Rama ka përgjegjësinë publike që të ndahet prej zëvendësit të tij. Do të thotë e shkarkon dhe në të njëjtën kohë shpall edhe arsyen e shkarkimit. Fakti që nuk e bëri i ka dhënë mundësinë z. Ahmetaj të plotësojë narrativën publike me tezën e tij se e larguan për ta bërë kokë turku (dhe dy duar për një krye janë).

Përpjekja e Ramës për ta ndarë qeverisjen e tij nga Ahmetaj, duke lënë SPAK ta veçojë si mollën e kalbur në përgun si kokra e mollës të qeverisë, do të kishte funksionuar nëse ish-zëvendësi i tij do ta kishte ulur kokën para dënimt. Këtë nuk kishte llogaritur Rama. Përndryshe do ta shpallte fajtor që në fillim, duke e shkarkuar për korrupsion dhe duke e flakur në kthetrat e SPAK.

Skema që Ahmetaj të bëhej kurban dhe të pranonte të shkante në të s'ëmës për partinë i kishte funksionuar me Sajmir Tahirin, me Alqi Bllakon apo Taulant Tushën. Me sa duket, një gjirokastri si Ahmetaj nuk mund t'i hahen gorica pas shpine.

Këto janë arsyet pse Rama hesht. Së pari, sepse i ka konsumuar lëvizjet në prapaskenë dhe nuk i ka mbetur më

asgjë për skenën. Po të kishte zgjedhur pistën e parë, ta shkarkonte për korrupsion, ai do të kishte folur me aktin dhe do të fitonte të drejtën e heshtjes.

Por, ka edhe një arsye të dytë. Rama është i detyruar të heshtë, sepse Ahmetaj e ka detyruar. Nëse Rama flet, i jep të drejtë Ahmetajt të flasë edhe më shumë. Nëse Rama flet është duke regjistruar material falas për shërbimet inteligjente që përmendi Ahmetaj.

Kështuqë, kryeministrit dhe të tijve, u intereson të heshtin. Të paktën deri të dielën kur PS mbledh Asamblenë dhe dikujt, askujt më shumë se Ramës, i takon të thotë diçka. Qoftë një përsëdytje kërcënimi për ata që prishin unitetit, që shkofshin në të s'ëmës, qafirët!

Janë disa ditë parapërgatitje për të thyer heshtjen e zhurmës që shkaktoi intervista e ish-zv/kryeministrit. Në mos për të folur me fjalë të paktën me akte. Për shembull duke gjetur një kokë turku, që zë vendin e kokës, tashmë zvicerane, tashmë neutrale, tashmë orë që nuk gabon në numërimin e fundit, të Arben Ahmetajt.

## HESHTJA E RAMËS PËR AKUZAT E AHMETAJT, ZGJATJE E AGONISË DHE E NDARJES MË TË PADENJË NGA PUSHTETI

IRENA BEQIRAJ

Intervista e ish njeriut më të rëndësishëm të qeverisë pas kryeministrit që sipas përcaktimit të bërë nga vetë kreu i qeverisë ka qenë edhe bashkëpunatori më i ngushtë i tij në këto 10 vite qeverisjeje, është vlerësuar dhe komentuar në mënyra të ndryshme.

Nga disa u konsiderua si hakmarrje, nga shumë tjerë si “mbrojtje duke sulmuar”, nga ca si një lëvizje taktike për t’u mos ekstraduar.

Për disa ai tha shumë, për të tjerë asgjë.

Ndërsa në këndvështrimin e një njeriu si unë që për disa kohë u përpoq të navigonte edhe “të mbijetonte” profesionalisht afër tyre, ajo intervistë mund të përkufizohet si “alter egoja” ose “vetja tjetër” e Udhëheqësit kundër Udhëheqësit!

Napoleoni dikur thoshte “A Leader is a Dealer in Hope” ose “Udhëheqësi është ai që shet shpresë”. Fjalët “udhëheqësi” dhe “tregëtari” që në anglisht janë “Leader edhe Dealer” përmbajnë të njëjtat shkronja, por në qeverisje dhe politikë ato mund të jenë imazhe që shumë lehtësisht zëvendesojnë njëri-tjetrin dhe fare lehtë mund të konsiderohen si “alter ego” të njëra-tjetrës. Thënë ndryshe “vetja tjetër”.

Që një udhëheqës të drejtojë të tjerët duke e shndërruar shpresën në



“ngjitëse” ose duke e kthyer atë në një fenomen masiv, ai duhet pikë së pari të negociojë drejtësisht me aftësitë e veta, kufizimet, sakrificat, pasiguritë, edhe ambiciet e tij. Kur nuk arrin të negociojë edhe të pranohet veten, udhëheqësi për pushtet negocion me gjithçka tjetër rreth tij, deri sa mbërrin që “vetja tjetër” e tij bëhet “tregëtari

pa skrupuj”.

Për “tregëtarin pa skrupuj” gjithçka është një mall, duke filluar nga njerëzit, qëndrimet, marrëdhëniet, premtimet, ëndërrat, aspiratat e deri tek Atdheu. Ai shet premtime të zbrazta për t’i siguruar vetes një angazhim; shet frikë për t’i siguruar

vetes siguri; shet ëndërra të rreme për të siguruar atë që ai aspiron ose dëshiron. Ai shet çdo njeri të aftë për të blerë “skllëvër të bindur”; shet favore për të siguruar besnikëri; shet interesa publike tek pronarët e mediave, duke blerë emisione televizive poshtëruese për të “pabindurit ndaj tij”. Ai shet lehtësisht pa asnjë procedurë detin,

tokën, ajrin tek lobistë, investitorë vendas e ndërkombëtarë apo tek kushdo tjetër që i siguron mbrojtje për interesat e tij.

Që imazhi i udhëheqësit të paraqitet i pacënuar në publik, vetja tjetër e tij “pra tregëtari” projektohet tek një grup i vogël njerëzish të rrethit të tij të ngushtë. Sot që arrij të gjykoj qetësisht, pa emocion e larg çdo marrëdhënie subjektive personale njërëz në rrethin më të ngushtë të Kryeministrit nuk janë e nuk kanë qenë gjë tjetër, veçse alterego të njëri-tjetrit. Edhe me pak vëmendje e kupton që në çdo qëndrim, veprim a fjalë, rrezatonin edhe rrezatojnë, cilësitë e qendrës së atij rrethi, të Kryeministrit!

Ndaj, në atë intervistë televizive nuk foli thjeshtë “një bashkëpunator dosido”, por i zgjedhuri i Kryeministrit ku ai pa të projektuar në 10 vite alteregon e tij. Nuk ishte Ahmetaj kundër Ramës, por vetja tjetër e Ramës e cila akuzoi Ramën publikisht.

Në përpjekje “për të larë duart” apo për t’u distancuar nga “Vetja tjetër” me shpresën se heshtja do t’i shërbejë relativizimit të akuzave, Kryeministri po zgjat agoninë e kapitullit të tij dhe të ndarjes më të padenjë nga pushteti.

## REPORTAZHI/ “REUTERS”: BAZË EMIGRANTËSH NË VENDIN MË TË PAZHVILLUAR NË EUROPE

Një port shqiptar që dikur ishte shtëpia e marinarëve të vendit do të pranojë emigrantë afrikanë, aziatikë dhe të Lindjes së Mesme të dërguar nga Italia si pjesë e një marrëveshjeje që ka marrë kritika nga grupet e të drejtave të njeriut. Marrëveshja, që pritet të ratifikohet nga parlamenti i Shqipërisë të enjten, do t’i lejojë Italisë të ndërtojë qendra të përpunimit të emigrantëve në territorin e vendit të Ballkanit Perëndimor, një nga më të varfrët dhe më pak të zhvilluarit në Europë.

Është shembulli i parë i një vendi jo të Bashkimit Evropian që pranon emigrantë në emër të një vendi të BE-së dhe është pjesë e një fushate në mbarë BE-në për të ndaluar imigracionin e parregullt që ka nxitur një rritje të popullaritetit të së djathtës ekstreme. Emigrantët që mbërrijnë në Itali do të dërgohen me varka në portin e ish-flotës detare të Shëngjinit, tashmë një destinacion popullor turistik në bregdetin piktoresk të Shqipërisë ve-riore të Adriatikut.

“Unë e mirëpres këtë marrëveshje. Ndjeh një detyrim shpirtëror sepse fëmijët e mi u rritën në Itali” – thotë Mhill Marku, një ish-oficer shqiptar, 4 fëmijët e të cilit jetojnë në Itali. “Italia ishte aty për ne në ditët më të vështira të historisë sonë në vitet ’90, ajo u bë porta dhe porta e Shqipërisë”,



– tha për Reuters Marku që jeton në Shëngjin.

Ai aludonte për shumë bashkatdhetarë që emigruan në Itali për të ikur nga kolapsi ekonomik në Shqipëri pas rënies së sundimit komunist.

Nga Shëngjini, emigrantët do të dërgohen në brendësi të vendit në Gjadër,

një qytet i vogël rreth 15 minuta larg me makinë, ku do të strehohen derisa të përpunohen letrat e tyre. Të dy objektet në Shëngjin dhe në Gjadër do të kenë personel italian. Numri i përgjithshëm i emigrantëve të pranishëm në një kohë në Shqipëri nuk mund të jetë më shumë se 3 mijë sipas marrëveshjes.

Komisioni Evropian në Bruksel ka deklaruar se skema italo-shqiptare nuk shkel ligjin e BE-së. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë vendosi të hënën se marrëveshja ishte “në përputhje me kushtetutën” dhe tha se tani mund të vazhdojë të ratifikohet në parlament.

Megjithatë, ekspertët e të drejtave paralajmërojnë se mund të jetë e vështirë për gjykatat italiane që të përpunojnë menjëherë kërkesat për azil ose apelimet kundër urdhrave të ndalimit nga njerëz të pritur në një vend tjetër dhe se procedurat e gjata mund të shtojnë një barrë të pajustifikuar mbi migrantët.

Shefi i Komisionit të Lartë të OKB-së për të drejtat e njeriut tha javën e kaluar se plani ngre shqetësime rreth ndalimit arbitrar dhe kushteve të jetesës për këta emigrantë. Marrëveshja po krahasohet me planin e qeverisë britanike për të dërguar azilkërkues në Ruandë në Afrikën Lindore, si një pengesë për udhëtimet e mëtejshme të emigrantëve me varka të vogla përtej Kanalit nga Franca, të organizuara nga trafikantët e qenieve njerëzore.

Skema e Ruandës u shpall e paligjshme në nëntor nga Gjykata e Lartë e Britanisë që është jashtë BE-së dhe qeveria ka prezantuar një tjetër legjislacion që shpreson se kur të miratohet, do të kapërcejë shqetësimet për të drejtat e njeriut. ©Marrë nga Reuters, LAPSI.al

VETON SURROI

A varet pensioni i serbëve të Kosovës nga shpejtësia e autobindës që bart paratë fizikisht për në vendbanimet e Kosovës apo nga shpejtësia e transferit elektronik në sistemin bankar, kjo është pyetja tash?

1.

Ka, qoftë edhe së paku për nevoja të këtij shkrimi, dy ligjërime evropiane lidhur me krizën e radhës në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë të “krizës së dinarit”.

Tashmë u bënë nja dy javë e ca që ligjërime kritik ndaj vendimeve të autoriteteve të Kosovës për të vendosur rregull në sistemin e pagesave po trajtohet si rrezikim potencial i gjendjes sociale të serbëve të Kosovës. Meqë tashmë njihet edhe zyrtarisht, nga Serbia dërgohen para për 87 mijë rroga, pensione, ndihma sociale dhe stimulim bujqësor, brenda një sistemi të mbyllur parashtetëror i cili operon me dinarë, ndalimi i transportit fizik (e operimit të tij si mënyrë legale pagese) po trajtohet si një veprim që mund të rrezikojë jetën normale të këtyre shfrytëzuesve. Dhe kjo brengë është e kuptueshme për faktin se ndalimi i qarkullimit fizik të dinarit është goditje në themel e sistemit financiar parashtetëror. Është edhe legjitime për vetë faktin se një sistem parashtetëror nuk është zëvendësuar qoftë me një transicion të qartë drejt një sistemi tjetër, qoftë me zëvendësimin imediat me një sistem tjetër.

Pra, nuk është për brengë fakti që ndalet prania fizike e dinarit, sepse as që e ka vendin si bazë e një sistemi pagesash parashtetërore, por është për brengë fakti se qytetarët që janë paguar deri para një jave me dinarë-qoftë për punë, pension a forma të përkrahjes sociale-nuk kanë gjetur një sistem tjetër që do t’ua jepte paratë në euro.

Kështu do të mund të reduktohej në interpretim mirëdashës e në themel ligjërime evropian, njëherë kur të zhvishet prej një toni alarmist-qortues ndaj autoriteteve të Kosovës dhe ftues që edhe kjo çështje të kalojë disi në ndërmjetësim të zotërinjve Borrell dhe Lajçak.

2.

Ekziston edhe një ligjërime tjetër, që është përputhur në kohë dhe



vetëm në dukje të parë nuk është i lidhur me “krizën e dinarit”. Është ligjërime i “Planit të rritjes” të BE-së për Ballkanin Perëndimor, që është ndërtuar brenda një logjike se gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor do të ndihmohen me një fond prej 6 miliardë eurosh në reformat e duhura, në mënyrë që deri më 2030 të integrohen në Tregun e përbashkët evropian. Në samitin e fundit Ballkani Perëndimor-BE të mbajtur në Shkup në fund të janarit madje u tha shprehimisht se ky plan i rritjes, masat e të cilat do të bëhen të njohura së shpejti, është i dizajnuar ashtu që asnjë shtet nuk mund ta pengojë tjetrin në reformimin dhe hyrjen në Tregun e përbashkët evropian.

Në fjalët e njërit prej diplomatëve kryesorë të angazhuar në këtë projekt e të shqiptuara në Shkup : “Ne u angazhuam të punojmë për një sërë reformash specifike, duke filluar me transportin më të lehtë të mallrave dhe parave që do të fillojnë , gjatë këtij viti, të tregojnë efekt praktik. Njëri prej tyre do të ulë kostot e lëvizjes së parave me rreth 3 deri në 5% për çdo transaksion. Janë para në xhepat e njerëzve. Ai lehtëson lëvizjet ndërkufitare të monedhës”.

Në këtë ligjërime supozohet se brenda gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë këtij viti do të lëvizin paratë prej njërit në

## NJË KAPELË EVROPIANE PËR “KRIZËN E DINARIT”

shtetin tjetër lirisht e me më pak kosto se deri tani. Dhe në këtë ligjërime jo që nuk ekziston “kriza e dinarit”- por flitet për një kategori tjetër lëvizje parash, që është krejtësisht tjetër prej asaj të dinarit që futet si para e gatshme në kamionë të blinduar dhe shpërndahet fizikisht nëpër vendbanime me shumicë serbe në Kosovë.

Nga ky këndvështrim problemi i lëvizshmërisë së parasë nuk matet me shpejtësinë e veturës së blinduar që i bart paratë prej kufirit Kosovë-Serbi drejt shfrytëzuesve të këtyre brenda Kosovës, por në eliminimin e pengesave juridiko-ekonomike në transferin elektronik ndërbanar.

3.

Ndonëse në dukje të parë ekziston mospërputhje mes dy ligjërimeve evropiane, kushtimisht të quajtura të “autobindës” dhe “transferit elektronik”, ajo në fakt mund të shndërrohet në ligjërime komplementare. Pra, po, në të njëjtën kohë flitet për një problem që është shkaktuar prej ndërprerjes së anakronizmit të bartjes së parasë me autobindë përtej kufirit dhe flitet për mënyrën se si të lehtësohet transferi i tanishëm elektronik i parasë përtej kufijve.

Nëse ekziston, kjo mospërputhje lehtë eliminohet konceptualisht

me refuzimin e mundësisë që të kthehem te qasja e autobindës. Pra, jo, nuk do të ketë më dinarë që do të hyjnë në kufi, të barten fizikisht nëpër vendbanime të Kosovës dhe t’iu shpërndahen shfrytëzuesve përfundimtarë si pjesë e një organizimi parashtetëror. Nga ky zinxhir i bartjes duhet eliminuar konceptin e kalimit fizik në kufi, konceptin e parasë fizike dhe konceptin e sistemit parashtetëror që e bën distribuimin (strukturat paralele të Serbisë në Kosovë).

Megjithatë do të mbetet pjesa më e rëndësishme e këtij përshkrimi e drejta dhe obligimi që qytetarët serbë të Kosovës të marrin pensione, ndihmë sociale dhe donacion legjitim për punët që i zhvillojnë në fushat që Serbia i konsideron si parësore (arsim dhe shëndetësi).

Dhe kjo e drejtë e obligim, ndonëse ka të bëjë me një problem të vockël në Ballkanin Perëndimor, mund të gjejë zgjidhje në një vizion më të gjerë evropian për Ballkanin Perëndimor. Nëse gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor janë pajtuar hiq më pak se para dy javësh që paraja të lëvizë në mënyrë elektronike mes vendeve të tyre për nja 3-5 për qind më lirë në komisione se deri tani, atëherë në këtë kontekst duhet të shihet edhe

lëvizja e parasë prej Serbisë për në Kosovë dhe anasjelltas. (Kjo çështje madje tejkalon edhe kontekstin e tanishëm të problemit rroga e pensione dhe ka të bëjë edhe me pagesat mes afaristëve të Kosovës dhe Serbisë e me rritjen e vëllimit të tregtisë mes këtyre dy vendeve).

Do të ishte jashtë logjikës që BE-ja të kërkojë shpejtësinë dhe uljen e komisioneve për lëvizjen elektronike mes gjashtë shtetesh të Ballkanit Perëndimor e disa javë më vonë t’u thuhet Kosovës e Serbisë që të gjejnë një modalitet që është tjetër fare, që nuk ka as elementin elektronik të transferit, as shpejtësinë e as uljen e koston të transferit për qytetarët e këtyre dy vendeve.

4.

Pra qenka lehtë e zgjidhshme? E zgjidhshme po, lehtë jo.

Janë dy çështje që kanë nevojë për vëmendje të veçantë.

Njëra është se si të bëhet kalimi prej një sistemi pagesash parashtetëror (sistemi paralel) ku qytetari serb tani ndihet i obliguar të marrë pjesë (madje me dëshmi besnikërie në nënshkrim, votim etj. ndaj shtetit të Serbisë) në një sistem të hapur ku llogaria e tij bankare nuk ka të bëjë me besnikëri ndaj kujt, por shërben për të shfrytëzuar të drejtën e tij për të marrë pension, ndihmë sociale , rrogë apo donacion.

E dyta është se si të bëhet brenda koordinatave të një vizioni më të madh, atij të Planit evropian të rritjes, në të Kosova dhe Serbia do të shfrytëzojnë këtë rast për të vendosur një transicion të shkurtër mes gjendjes së tanishme të pagesave dhe asaj të rritjes të shpejtësisë elektronike të qarkullimit financiar mes dy shteteve. Përfituesit imediat të një transicioni të këtillë do të ishin serbët e Kosovës të cilët brenda javësh do të merrin pagesat në euro në xhirrollogaritë bankare. Por njëkohësisht edhe Serbia e Kosova do të tejkalonin “krizën” e tanishme me një vizion evropian.

Megjithatë, kjo nënkupton që dy shtetet duhet të bashkëpunojnë, dhe kjo është treguar deri tani një gjë jo e lehtë.

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

**Akoma nuk jeni regjistruar në Google**



- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing

## LONDON

Për çdo konsultim mund te vini në  
zyrat tona

020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545

Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road,  
London E13 8HT

## OLA XAMA

Dje pashë një investigim shumë të mirë që i kishte bërë çështjes së Eko Park kolegu Julian Hoxhaj në emisionin Plug. I përmbledhur në pak fjalë, emisioni faktonte me dokumenta këtë skemë: në prill 2019 kompanitë Integrated Energy (ajo e inceneratorit) dhe studio Casanova Hernandes Architects kishin lidhur një kontratë për projektimin dhe zbatimin e projektit Eco Park.

Kontrata ishte lidhur përpara se të hapet tenderi për punimet, madje dhe përpara se të komunikohet vendimi politik i kryeministrit se vendpozitimi i mbetjeve në Durrës do të mbyllet. Mediat pas lajmit që dhe kreu i qeverisë nisën të nxirrin foto nga projekti i studio Casanova Hernandes Architects, zyrë që u pagua 220 mijë euro nga koncesionari i inceneratorit.

Një vit më parë Këshilli Bashkiak në Durrës kishte shpallur emergjencën mjedisore duke i hapur rrugën ish-kreut të bashkisë Vangjush Dako që të depozitonte mbetjet në landfillin e Sharrës. Të ardhurat e koncesionarit u rritën dhe më shumë, jo vetëm nga bashkia Tiranës dhe tarifa e dherave por dhe bashki të tjera.

Në tetor të vitit 2019 hapet tenderi për mbylljen e vend depozitimit të mbetjeve në Porto Romano, i cili çuditërisht anulohet në 3 dhjetor. U tha se fokusi ishte te tërmeti që goditi vendin. Komiteti Ndërmintor i Emergjencës Civile vendos që mbetjet e krijuara nga tërmeti të dërgoheshin në Porto Romano dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjelles

## ECO PARK - MË SHUMË KA GJETUR MEDIA SESA PROKURORIA E POSAÇME

Kanalizimeve ngarkohet autoriteti që do të rijetësonte zonën.

Emergjencia e tërmetit i hapi rrugën AKUM të kontraktonte një kompani me negociim të drejtpërdrejtë pa zhvilluar tender. Lidhet kontrata me vlerë 19 milion euro me firmën De Mare (e krijuar vetëm një muaj para lidhjes së kontratës) dhe Victoria Invest International, kompani e denoncuar nga deputeti Taulant Balla se kishte lidhje me kreun e PD Lulzim Basha, madje përdorte dhe një automjet në emër të kësaj shoqërie. Pas firmosjes së kontratës PD 'harroi' denoncimet për inceneratorët disa kohë.

Ndryshe nga sa detyronte kontrata se Eko Park do të zbatohet nga kompan-

itë që ishin kontraktuar, pas disa muajve punimet i kalojnë firmës Artcon, e cila zotohet t'i kryejë për vlerën 7,5 milion euro dhe 11.5 milion ndahen me firmat e që kishin kontratën.

Faturat e porosive të punimeve që ka bërë Artcon tregojnë se si fryhen me 3-4 herë preventivët dhe vidhen paratë tona, ndërsa vlera reale e ndërtimit nuk shkon më shumë se 3 milion euro! Vetë kompania kontraktore rezultoi të ketë qënë në emër të bashkëshortes së Klodian Zotos dhe kur u nënkontraktua ishte në emër të Denis Ymerit, i punësuar shofer në inceneratorin e Tiranës.

E gjithë kjo mund të ishte ndaluar nëse drejtësia e re do të kishte bërë punën në mbrojtje të interesit publik. Më kujtohet se në shkurt të vitit 2020,

më nxorrën nga montazhi sepse do të hynte lajmi i parë, shumë i rëndësishëm: SPAK niste hetimet për tenderin e landfillit në Porto Romano. Sot bëhen 4 vjet. Më shumë ka gjetur media sesa Prokuroria e Posaçme.

Ky njoftim në ato kohë më la përshlyetje pozitive për drejtësinë e re që kishte nisur një hetim kryesisht dhe kishte regjistruar procedim penal për veprën 'shkelje e barazisë në tendera'. Mu duk i tillë se me aq sa kuptoj dhe më kanë shpjeguar, modeli i sistemit me prokurorë të pavarur u zgjodh i tillë që të mos kemi prokurori që punojnë në bazë të kallzimeve por dhe verifikojnë kur ngrihen flamuj të kuq nga media dhe shoqëria civile.

Por ne në Shqipëri e bëmë si shqiptarët: hoqëm përgjegjësinë institucionale dhe janë bërë hetimet e prokurorisë çarçaf me përplasje interesash. Për të njëjtën çështje çfarë shkruan një prokuror nuk shkruan tjetri...

# POROSISNI kartat e biznesit tuaj

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona  
Na kontaktoni:  
**020 7018 7929 073 4066 5946 078 5997 7545**  
Adresa e zyrave: **30 Avenons Road, London, E13 8HT**



## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners




Adresa e zyrave:  
**30 Avenons Road, London, E13 8HT**

Na kontaktoni:  
**020 7018 7929  
073 4066 5946**



NA KOTAKTONI

0 7947 785174



## SHERBIME Te TONA

### NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

### SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

### BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

### DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



## INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi  
Per Shendetin  
Tuaj

HAPUR  
7 DIT  
NE  
JAVE

Numer Telefon  
020 8341 3185

E-mail Address  
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone  
573 Green lanes, Harringay, London  
N8 0RL

Oraret Sherbimet  
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm  
Te Dielen : 11 am- 6 pm



# CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM  
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,  
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes ( Sodium + Potassium + Chloride )  
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



# Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059





# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



Business Cards 

Banners 

Posters 

Flyers 

Video Marketing 

**Adresa e zyrave** 

**30 Avenons Road London E13 8HT**



**020 7018 7929**

**Mobile 073 4066 5946**